



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 56, datë 10.04.2020<sup>1</sup>**

**PËR**  
**MARRJEN E MASAVE NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE PËR SHKAK TË**  
**SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID-19.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 149 e vijues të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Ekipit Teknik të Mbikëqyrjes së Krizave të Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Si pasojë e pandemisë globale COVID-19, autoritetet rregullatore po ndërmarrin masa për kalimin e situatës në mënyrën më efektive të mundshme.

Autoriteti, është duke ndjekur me kujdes zhvillimet që lidhen me situatën e krijuar nga COVID-19, veçanërisht uljen e ndjeshme të të ardhurave të shoqërive të sigurimit, faktor që mund të ndikojë në situatën e likuiditetit afatshkurtër të shoqërive por edhe të treguesve financiarë të aftësisë paguese dhe atij të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.

Nisur nga fakti se, ende nuk parashikohet saktë kohëzgjatja e kësaj situatë, me qëllim parandalimin e rrethanave për marrjen e masave mbikëqyrëse të parashikuara në nenin 150, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, konsiderohet e nevojshme marrja e disa masave.

Këto masa kanë qëllim ruajtjen e nivelit të likuiditetit dhe treguesve financiarë të aftësisë paguese dhe të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, në funksion të mbrojtjes të interesave të policëmbajtësve.

---

<sup>1</sup> Shfuqizuar me vendimin e Bordit nr. 68, datë 28.04.2021

**V E N D O S I:**

- 1. Shoqëritë e sigurimit të pezullojnë shpërndarjen e fitimit në formën e dividendëve ose të dividendëve të ndërmjetëm ose në formën e pagesave të bazuara në pjesëmarrjen në fitim të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë apo punonjësve të tjerë.**
- 2. Shoqëritë e sigurimit duhet të marrin masa dhe të zbatojnë një qasje konservative në lidhje me shpërblimet variabël, bazuar në politikat e tyre dhe në çdo rast shtyrjen e tyre në kohë.**
- 3. Masat e parashikuara në këtë vendim, do të zbatohen deri në marrjen e një tjetër vendimi, nga Bordi i Autoritetit.**
- 4. Ngarkohen shoqëritë për zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Ervin METE \_\_\_\_\_ KRYETAR**

**Idlir GJATA \_\_\_\_\_ ANËTAR**

**Deniz DERALLA \_\_\_\_\_ ANËTAR**